

INFORMACIONI FINANCIAR QË PËRMBAN RAPORTI PËR KREDIMARRËSIN

Informacioni financiar përfshin të dhënat financiare në lidhje me kredinë/të e akorduara kredimarrësit, si dhe të dhënat financiare në lidhje me kredinë/të, në të cilat kredimarrësi shfaqet si person i lidhur.

Leximi i të dhënave financiare në lidhje me kredinë/të e akorduara kredimarrësit:

I. Ekspozimi në sistemin bankar/financiar i kredimarrësit si Subjekt i Drejtpërdrejtë

1. Lloji i kredisë – njëri nga 6 opsionet, i shprehur me kodet përkatëse ose me fjalë: 0-**Kredi**; 1 – **Overdraft**; 2 - **Kartë krediti**; 3 - **Letër kredi**; 4 – **Garanci**; 5 - **Të tjera**.
2. **Data e disbursimit** të kredisë – data në të cilën, fondet janë transferuar për llogari të kredimarrësit.
3. **Shuma e Aprovuar** e kredisë – shuma totale, për të cilën banka është angazhuar të financojë kredimarrësin.
4. **Shuma e Disbursuar** e kredisë – mund të jetë më e vogël ose e barabartë me shumën e aprovuar të kredisë.
5. **Shuma e Këstit Mujor** – madhësia mesatare e detyrimit mujor të kredimarrësit për një kredi të caktuar.
6. **Shuma e Mbetur/Teprica e kredisë** – Gjendja e detyrimit të kredimarrësit në datën e nxjerrjes së raportit, pas zbritjes së pagesave të kryera dhe shtimit të interesave të përlogaritur.
7. **Shuma e Vonuar** – pasqyron detyrimin e papaguar në kohë të kredimarrësit.
8. **Monedha / Valuta e Kredisë** – njëri prej 7 opsioneve, shprehur me kodet përkatëse: 0 – Lek; 1 – Euro; 2 – Usd; 3 – GBP; 4 – Yen; 5 – CHF; 6 – Të tjera.
9. **Statusi** i klasifikimit të kredisë– njëri prej 8 opsioneve, shprehur me kodet përkatëse: 0 – Standard; 1 – Në ndjekje; 2 – Nënstandard; 3 – E dyshimtë; 4 – E humbur; 5 – E paguar; 6 – E fshirë nga bilanci; 7 – E anuluar.

Kreditë (0) – ‘Standard’ dhe (1) – ‘Në ndjekje’, hyjnë në grupin e kredive cilësore. Kreditë (2) - ‘Nënstandard’, (3) – ‘E dyshimtë’, (4) – ‘E humbur’ hyjnë në grupin e kredive me probleme.

10. **Historiku** i klasifikimit – pasqyron klasifikimin e kredisë, sipas pikës 9, për 24 periudhat më të fundit, duke filluar nga periudha aktuale.
11. **Kolaterali** – pasqyron tërësinë e kolateraleve të ndarë në rreshta, ku për secilin raportohet:
 - *numri serial i kolateralit* – për pasuritë e patundshme raportohet: numri i pasurisë ose numri i hipotekës dhe/ose numri i regjistrimit dhe/ose numri i faqes; Për mjetet e transportit raportohet numri i shasisë; për makineri/pajisje raportohet numri i shasisë së linjës së prodhimit.
 - *Iloji i kolateralit* –njëri prej 6 opsioneve, shprehur me kodet përkatëse: 0 – Hipotekë; 1 – Inventar; 2 – Makineri dhe pajisje; 3 – Vetura; 4 – Depozitë në “cash”; 5 – Të tjera;
 - *përshkrimi i kolateralit* – tekst i lirë, përshkrim i shkurtër i kolateralit.

II. Historiku i kredimarrësit në sistemin bankar si Subjekt i Drejtpërdrejtë

Raporti për kredimarrësin pasqyron dhe një përmbledhje të totalit të kredive akorduar kredimarrësit, duke prezantuar numrin total të këtyre kredive, përfshirë edhe ato kredi të cilat aktualisht nuk janë aktive e që kanë status 5 “Paguar” ose 6 “Fshirë”, së bashku me disa prej të dhënave të mësipërme financiare (konkretisht të dhënat nr: 3; 4; 5; 6 dhe 7).

III. Kredimarrësi si person i lidhur

Në këtë seksion pasqyrohet informacioni si më poshtë

- Tërësinë e informacionit financiar trajtuar për kredinë/të, në të cilat identifikohet si person i lidhur si dhe rolin e personit të lidhur, një ose disa prej 6 opsioneve të parashikuara të cilat shprehen me kodet përkatëse ose me fjalë: 0 – Garantues; 1 – Bashkëshort; 2 – Drejtor; 3 – Pronar/aksioner; 4 – Bashkëkredimarrës; 5 – Firmë e lidhur.

IV. Ekspozimi në total i kredimarrësit në sistemin bankar duke përfshirë edhe kreditë në të cilat shfaqet si person i lidhur

Raporti për kredimarrësin pasqyron dhe një përmbledhje të totalit të kredive akorduar kredimarrësit dhe totalit të kredive, në të cilat ai shfaqet si person i lidhur, duke prezantuar numrin total të këtyre kredive, së bashku me disa prej të dhënave financiare (konkretisht të dhënat nr: 3; 4; 5; 6 dhe 7).

Gjithashtu në raportin për kredimarrësin shfaqen dhe 5 (pesë) kërkimet e fundit që subjektet bankare/financiare kanë kryer për personin apo subjektin juridik.

Përveç sa më sipër, Raporti i Kredimarrësit evidenton gjithashtu dhe kreditë në të cilat kredimarrësi shfaqet si person i drejtpërdrejtë apo si person i lidhur, të cilat plotësojnë kriteret për tu raportuar si:

- **Kredi në proces gjyqësor** – Ky status identifikohet në Raport, për kreditë për të cilat banka disponon një Urdhër Ekzekutimi të lëshuar nga gjykata me qëllim shlyerjen e pretendimeve kundrejt huamarrësve.
- **Kredi të ristrukturuara** – Identifikohen në Raport ato kredi të cilat plotësojnë kriteret si të tilla, në bazë dhe për zbatim të rregullores nr.62 datë 14.09.2011, “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja” neni 13, dhe rregullores nr.02, datë 17.01.2013 “Për administrimin e rrezikut të kredisë në veprimtarinë e subjekteve financiare jo banka” neni 16.
- **Kredi të shitura**- Identifikohen në raport ato kredi të cilat janë shitur tek subjekte të tjera financiare

Në çdo rast që nuk do të jeni dakord, me të dhënat që paraqiten në raportin tuaj të kredimarrësit, mbas plotësimit të formularit përkatës për këtë qëllim,¹ lutemi drejtohuni pranë Zyrës së Regjistrimit të kredive të Bankës së Shqipërisë, për të rishikuar/verifikuar informacionin që subjektet raportuese kanë raportuar për Ju në Regjistrin e Kredive. Për rishikimin/verifikimin e të dhënave të paraqitura në raportin fillestar të kredimarrësit, nuk nevojitet të paguhet asnjë tarifë shtesë.

¹ Formulari i kërkesës për rishikimin e raportit, gjendet tek faqja zyrtare e Bankës së Shqipërisë ose meret pa pagesë pranë Zyrës së Regjistrimit të Kredive.